



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
SP-037  
Prishtinë, më 5, 6, 9, 12, 19 dhe 23 korrik 2018

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 5, 6, 9, 12, 19 DHE 23 KORRIK 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Müfera Srbica-Shinik.

Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2018.

Në fillim, deputeti Faton Topalli propozoi që Kuvendi ta miratojë një rezolutë për reduktimin e procedurave të kontrollit të kalimit kufitar për bashkatdhetarët që vijnë për pushime gjatë verës. Diskutimi i plotë i deputetit Faton Topalli është dhënë në transkript.

Lidhur me propozimin e lartcekur, kryetari i Kuvendit propozoi që të konsultohen grupet parlamentare dhe pastaj teksti i propozim-rezolutës të procedohet për miratim.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Mimoza Kusari-Lila, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Besa Baftiu dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me emërimet e disa koordinatorëve në Qeveri.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Driton Çausi i parashtrroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kryeministri nga rekomandimet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës lidhur me sigurinë e ushqimit.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Armend Zemaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me masat e ndërmarra nga institucionet e sigurisë për parandalimin dhe luftimin e shitjes dhe përdorimit të drogave të nxënësit dhe të rinjtë.

Ministri Bejtush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Faton Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me çmimet e biletave të udhëtimeve ajrore.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për marrjen në menaxhim të hapësirës ajrore nga autoritetet kosovare.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në lidhjet me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri për t'i ndihmuar familjet të cilat janë dëmtuar nga breshri.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Lutfi Zharku i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me një deklaratë të ministrit për disa projektet gjatë kohës sa z. Zharku ishte ministër i Infrastrukturës.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Armend Zemaj i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Palnifikimit Hapsinor, Albena Reshitaj, në lidhje me shqetësimet e qytetarëve për ndërtimin e hidrocentralit në rrjedhën e lumit në grykën e Lloqanit.

Ministrja Albena Reshitja iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Imet Rrahmani i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me kompensimet e pjesëtarëve të policisë për punën shtesë dhe gjatë festave zyrtare.

Ministri Bejtush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për asfaltimin e rrugës “Tirana” në komunën e Mitrovicës Veriore.

Ministri Pal Lekaj, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për ndërtimin e kulmeve të tri (3) shtëpive në lagjen “Kodra e Minatorëve” në Mitrovicë.

Ministri Skender Reçica, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për ndërtimin e dhjetë (10) shtëpive çdo vit në lagjen “Kroi i Vitakut” në Mitrovicë.

Ministri Skender Reçica, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për ndërtimin e dy (2) shtëpive në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë.

Ministri Skender Reçica, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për fasadimin e shkollës fillore “Aziz Sylejmani” në Mitrovicë.

Ministri Shyqiri Bytyqi, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për ndërtimin e shkollës fillore në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë.

Ministri Shyqiri Bytyqi, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nuk i ishte përgjigjur pyetjes së deputetit.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 17, 30 e 31 maj, 1, 4, 5, 8 dhe 28 qershor 2018.

### **4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në kontratën për ndërtimin e autostradës R6 “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se GP i Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP i LDK-së kanë parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53

milione eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizjes Vetëvendosje, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Gjithashtu, edhe deputeti Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e paraqiti dhe arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin z. Haradinaj, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Lidhur me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Liburn Aliu, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s, Lumir Abdixhiku, Sami Kurteshi, Shqipe Pantina, Blerim Kuçi, Milaim Zeka, Arbër Rexhaj, Enver Hoti, Salih Zyba dhe Ismajl Kurteshi, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve, deputeti Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje e paraqiti tekstin e propozim-rezolutës, si dhe kërkoi nga grupet parlamentare që të harmonizohet teksti i propozuar.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, nuk u procedua votimi i kësaj propozim-rezolute.

Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit është bërë më 12 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 37,  
Kundër----- 47,  
Abstenime----- 1.

Kuvendi nuk e miratoi propozim-rezolutën në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në

kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit, të propozuar nga grupet parlamentare të LVV-së dhe LDK-së.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 15:35.

\* \* \*

*E premte, më 6 korrik 2018*  
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i ndihmuar nga znj. Muferra Srbica-Shinik, nënkryetare e Kuvendit.

Në fillim kryetari i GP të PDK-së, Memli Krasniqi, propozoi që pika 14 e rendit të ditës, Propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të shqyrtohet në fillim të seancës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e z. Memli Krasniqi dhe rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin e kryetarit të GP të PDK-së dhe vendosi që propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të shqyrtohet në fillim të seancës.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

### **Votimi i Propozim-rezolutës së propozuar nga deputeti Faton Topalli**

Kryetari e ftoi deputetin Faton Topalli që ta paraqesë tekstin e harmonizuar të Propozim-rezolutës lidhur me reduktimin e kontrolleve të automjeteve në pikat kufitare për bashkatdhetarët.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 7.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

### **REZOLUTË**

1. Të reduktohen në minimum procedurat e përditshme të kontrollit të kalimit kufitar për bashkatdhetarët tanë në të gjitha pikat kufitare të Republikës së Kosovës.

2. Hyrja e veturave të bashkatdhetarëve nëpër këto pika kufitare me Republikën e Kosovës të bëhet pa iu nënshtruar kontrollit të domosdoshëm, ndërsa kontrolli i tyre të bëhet me metodën e rastit.
3. Gjatë hyrjes në kufi kontrollohet vetëm posedimi i policave kufitare për makina, për të siguruar dëmet e mundshme të makinave.
4. Heqja e procedurave të rregullta aplikohet për periudhën 15 korrik 2018 – 15 shtator 2018.
5. Të dyfishohen kapacitetet e punës në të gjitha pikat kufitare gjatë periudhës në fjalë.
6. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e kësaj rezolute.
7. Kjo rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

#### **14. Propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese i ka zhvilluar procedurat e parapara për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit i ka paraqitur për votim listën e ngushtë me gjashtë kandidatë për tri pozita.

Pastaj, kryetari i sqaroi procedurat e veçanta, të parapara në nenin 114 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe propozoi që pasi me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese nuk është e përcaktuar procedura e votimit në seancë plenare, të miratohet procedura e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i hodhi në votim procedurat e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Votimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës bëhet me votim të fshehtë.
2. Deputeti i Kuvendit, prej gjashtë (6) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, të rekomanduar nga Komisioni i posaçëm, voton për tre (3) kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
3. Nëse në votimin e parë asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me 5 kandidatë për 3 pozita.
4. Nëse në votimin e dytë asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me 4 kandidatë për 3 pozita.
5. Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Për rastet në vijim komisioni nuk ka propozuar, andaj Kuvendi duhet të deklarohet edhe për rastet si në vijim:

6. Nëse në votimin e parë, vetëm 1 kandidat e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me 4 kandidatë për 2 pozita.

7. Nëse në votimin e parë vetëm 2 kandidatë e marrin numrin e nevojshëm të votave, 2 kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me 2 kandidatë për 1 pozitë.

8. Nëse në votimin vijues asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Pastaj, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues për t'i zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Hajdar Beqa, GP PDK,  
Arbër Rexhaj, GP LVV,  
Frashër Krasniqi, GP PSD,  
Rasim Selmanaj, GP AAK,  
Jasmina Zhivković, GP Lista serbe,  
Albulena Balaj-Halimaj, GP Nisma dhe  
Bahrim Shabani, GP "6+".

Më pas, kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për propozimin e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në rundin e parë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese e paraqiti deputeti Hajdar Beqa.

Për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese rezultati i votimit ishte:

- Në votim kanë marrë pjesë 97 deputetë.
- Fletëvotime të pavlefshme nuk kishte.

Votat e fituara nga kandidatët e propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ishin, si në vijim:

1. Nexhmi Rexhepi ----- 63 vota,
2. Safet Hoxha ----- 64 vota
3. Resmije Istrefi-Peci ----- 83 vota,
4. Shkëmb Manaj ----- 23 vota,
5. Vigan Qorolli ----- 09 vota,
7. Emrush Kastrati-----08 vota.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, vetëm znj. Resmije Istrefi-Peci i mori votat e nevojshme për t'u propozuar për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

Në bazë të proceduarave të votimit të miratuara nga Kuvendit, një (1) kandidat (Emrush Kastrati), që ka fituar më së paku vota hiqet nga fletëvotimi dhe votimi përsëritet me katër (4) kandidatët e tjerë për dy pozitat (Safet Hoxha, Nexhmi Rexhepi, Shkëmb Manaj dhe Vigan Qorolli).

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese e paraqiti deputetja Evgjeni Thaçi-Dragusha, e cila në Komisionin votues e zëvendësoi deputetin Hajdar Beqa.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim morën pjesë 92 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 5 fletëvotime.

Votat e fituara nga kandidatët e propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ishin si në vijim:

1. Safet Hoxha ----- 62 vota,
2. Nexhmi Rexhepi ----- 66 vota,
3. Shkëmb Manaj ----- 23 vota,
4. Vigan Qorolli ----- 06 vota.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit të dy rundeve,

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Për përzgjedhjen e tre (3) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Znj. Resmije Istrefi-Peci, z. Nexhmi Rexhepi dhe z. Safet Hoxha i propozohen Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e tyre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

### **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për efikasitet të energjisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për efikasitet të energjisë. Në fund, ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.



Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë diskutuan: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe në emër të GP të PDK-së; Mimoza Kusari-Lila, në emër të GP të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të GP të LVV-së dhe Visar Ymeri në emër të GP të PSD-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë është bërë më 12 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,  
Kundër----- 8,  
Abstenime----- 4.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pas konsultimit me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 16:55, për të vazhduar të hënën, më 9 korrik 2018.

\* \* \*

*E hënë, më 9 korrik 2018*  
*Vazhdimi i seancës plenare*

Kryesuesi e vazhdoi seancën me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020”**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020” dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020”, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional dhe në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Memli Krasniqi, Frashër Krasniqi si dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Në vazhdimin e seancës plenare më 19 korrik 2018 Kuvendi e miratoi amendamentin numër 1 të propozuar nga Komisionit Funkcional.

Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020” është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 85,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 8.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020”.

*Kryesuesi i hoqi nga rendit të ditës pikat 7: Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe 8: Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, ngase nuk ishin të pranishëm në seancë propozuesit për t'i paraqitur dhe arsyetuar projektligjet.*

#### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Deputeti Mërgim Lushtaku, në cilësinë e propozuesit, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Në fund ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Frashër Krasniqi, Milaim Zeka, Teuta Haxhiu, Elmi Reçica, Bekim Haxhiu si dhe ministrja e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete është bërë më 12 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 37,  
Kundër-----11,  
Abstenime-----13.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### **15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017 diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Xhevahire Izmaku, në emër të GP të PDK-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate dhe Daut Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017 është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 52,  
Kundër-----8,  
Abstenime-----5.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017.

### **16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017 diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së; Gani Dreshaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017 është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 51,  
Kundër-----0  
Abstenime-----10.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017.

Kryetari i ndërpreu punimet e kësaj seance plenare në orën 19:25.

\* \* \*

Në fillim Kuvendi i miratoi në parim Projektligjin për efikasitet të energjisë dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete. Rezultatet e votimeve janë pasqyruar së bashku me shqyrtimet e pikave përkatëse.

Pastaj, seanca plenare i vazhdoi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

## **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbime postare dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, znj.Sala Berisha-Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Më pas, kryesuesi tha se Komisioni për Integritet Evropian nuk e ka shqyrtuar projektligjin në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, por në ndërkohë pasi që Komisioni Funkcional e ka dorëzuar raportin final, Komisioni për Integritet Evropian ka konstatuar se amendamentet: 2, 6, 7, 8 dhe 9 nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e tyre.

Më pas kryesuesi e hapi debatin për mospajtimin e komisioneve parlamentare lidhur me amendamentet në fjalë.

Lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për shërbime postare diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Sasha Milosavleviq, në emër të GP të Listës serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Driton Selmanaj, Hykmete Bajrami dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së, propozoi mocion që të harmonizohen qendrimet e komisioneve përkatëse parlamentare lidhur me amendamentet e propozuara në këtë projektligj dhe pastaj të rikthehen në seancë për votim.

Kryetari e hodhi në votim mocionin e deputetit Armend Zemaj.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 37,  
Kundër-----11,  
Abstenime-----13.

Kuvendi mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Ngarkohen Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe Komisioni për Integritet Evropian që t'i harmonizojnë qëndrimet në lidhje me amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me rekomandime.

### **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për metrologji dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 39 amendamente.

Kryesuesi i hodhi në votim përnjëherë të gjitha amendamentet e propozuara.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi amendamentet nga 1 deri në 39.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,  
Kundër ----- 4,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-037 për masat mbrojtëse në importe.

### **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Liburn Aliu, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan deputetët: Glauk Konjufca, Armend Zemaj, Arben Gashi, Daut Haradinaj, Enver Hoti Bekim Haxhiu, Memli Krasniqi dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 28 amendamente.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi në këtë seancë e miratoi amendamentin numër një (1), ndërsa në vazhdimin e seancës plenare më 19 korrik 2018 Kuvendi nuk i miratoi amendamentet numër dy (2) dhe tre (3) të propozuara nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të amendamenteve të tjera të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në lexim të dytë i Projektligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje është bërë më 23 korrik 2018.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 4, 7, 14, 16, 18, 21, 27 dhe 28.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 19, 20, 22, 23, 24, 25 dhe 26.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,  
Kundër -----10,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

### **13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 8 amendamente.

Kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë më 23 korrik 2018.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 58,  
Kundër -----1,  
Abstenime ----- 9.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

### **17. Shqyrtimi i kërkesave të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit, si dhe për zgjatjen e mandatit (afatit) të këtij komisioni**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës ka kërkuar nga Kuvendi miratimin e buxhetit të këtij komisioni dhe zgjatjen e mandatit (afatit) të tij nga një (1) muaj në gjashtë (6) muaj.

Gjithashtu kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me miratimin e buxhetit të këtij komisioni.

Kryesuesi i Komisionit Hetimor Parlamentar, deputeti Dardan Sejdiu, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën e këtij komisioni.

Lidhur me kërkesat e Komisionit Hetimor Parlamentar për miratimin e buxhetit, si dhe për zgjatjen e mandatit (afatit) të këtij komisioni diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të NISMA-s, Naser Osmani, Hajdar Beqa, Milaim Zeka dhe Mërgim Lushtuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar për zgjatjen e mandatit (afatit) nga një (1) muaj në gjashtë (6) muaj.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 58,  
Kundër -----1,  
Abstenime ----- 9.



Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

1. Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës i zgjatet mandati (afati) prej një (1) muaji në gjashtë (6) muaj nga dita e themelimit të tij.
2. Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me buxhetin e tij t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit.

### **18. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave i ka rekomanduar Kuvendit zgjedhjen e një anëtari nga dy kandidatët e propozuar.

Deputeti Rasim Selmanaj e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve të tjera.

Pastaj, kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në komisionin votues për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekaliu, GP LDK,  
Hajdar Beqa, GP PDK,  
Valon Ramadani, GP LVV,  
Faton Topalli, GP PSD,  
Rasim Selmanaj, GP AAK,  
Adem Hoxha, GP Lista serbe,  
Veton Berisha, GP Nisma dhe  
Albert Kinolli, GP "6+".

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve të tjera e paraqiti deputeti Hajdar Beqa.

Rezultati i votimit ishte:

Në votim kanë marrë pjesë 75 deputetë:  
Të pavlefshme ishin 40 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Azra Desiq ..... 19 vota dhe
2. Fatih Basha .....17 vota.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

1. Kandidatët e propozuar: Azra Desiq dhe Fatih Basha, për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve të tjera, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar në këtë komision.

2. Të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve të tjera.

### **19. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Radiotelevizioni i Kosovës e ka informuar Kuvendin për nominimet e kandidatëve për tre (3) anëtarë në Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Pastaj kryesuesi i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i japin propozimet për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,  
Kundër ----- 2,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

**I.** Formohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, .....nga GP i PDK-së, kryetare,
2. Valon Ramadani, .....nga GP i LVV-së, zv.kryetar i parë,
3. Jelena Bontiq, .....nga GP i LS-së, zv.kryetare e dytë,
4. Valentina Bunjaku-Rexhepi,.....nga GP i LDK-së, anëtare,
5. Armend Zemaj,.....nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Luljeta Gutaj-Veselaj,.....nga GP i PDK-së, anëtare,
7. Adem Mikullovc, .....nga GP i LVV-së, anëtar,
8. Frashër Krasniqi,.....nga GP i PSD-së, anëtar,
9. Rasim Selmanaj, .....nga GP i AAK-së, anëtar,
10. Milaim Zeka, .....nga GP Nisma Socialdemokrate, anëtar dhe

11. Albert Kinolli,.....nga GP “6+”, anëtar.

**II.** Komisioni ad-hoc, në bazë të nenit 26, pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar, si dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

## **20. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

Kryesuesi i njoftoi deputetët me propozimet e Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimet e Grupit Parlamentar të AAK-së.

Kuvendi mori këtë:

### V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006.

Vendimi nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Deputeti Muharrem Nitaj emërohet kryetar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Daut Haradinaj.
2. Deputeti Daut Haradinaj emërohet anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të deputetit Muharrem Nitaj.
3. Deputeti Muharrem Nitaj emërohet anëtar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në vend të deputetit Gani Dreshaj.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 12 korrik 2018, në orën 16:00.

Kryetari i Kuvendit:  
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*